



Komisioneri për Mbrojtjen  
nga Diskriminimi

Commissioner for Protection  
from Discrimination



Qendra e Koordinimit  
KUNDËR EKSTREMIZMIT  
TË DHUNSHËM  
- Shqipëri

**Komisionerit për Mbrojtjen nga  
Diskriminimi**

Nr. 71 Prot.

Tiranë, më 11.01.2022

**Qendra e Koordinimit  
Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm**

Nr. 5 Prot.

Tiranë, më 11.01.2022

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

*Ndërmjet*

**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

*Dhe*

**QENDRËS SË KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM,  
TIRANË**

### **Parathënie**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (që në këtë dokument do t'i referohemi si "Marrëveshje" lidhet mes **Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi** (që në këtë dokument do të quhet "KMD"), i përfaqësuar nga Z. Robert Gajda dhe **Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm** (që në këtë dokument do të quhet "QKEDH"), e përfaqësuar nga Znj. Lejdi Dervishi, Drejtor.

QKEDH-ja dhe KMD-ja do të referohen në këtë dokument si "Palët".

Direktivat e BE në fushën e mosdiskriminimit me adresë Rruga e Durrësit, nr.27, Tiranë, përfaqësuar nga **Z. Robert Gajda, Komisioner**.

**QKEDH-ja** si institucion publik, i krijuar me Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 737, datë 13.12.2017, si person juridik publik, buxhetor në varësi të Kryeministrit, me adresë Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 3, Kati 2 Tiranë, përfaqësuar nga **Znj. Lejdi Dervishi, Drejtor**.

**Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm** kanë një eksperiencë dhe përvojë të gjatë në garantimin e zbatimit dhe realizimit të misioneve të përbashkëta në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dëshirojnë që të çojnë përpara bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet tyre në këtë fushë, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, për sa më poshtë:

### **Neni I** **OBJEKTI**

Kjo marrëveshje ka për objekt institucionalizimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e rregullave dhe mënyrave brenda të cilave Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm do të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre të bashkëpunimit të ndërsjellë, në kuadër të punës së përbashkët për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm.

### **Neni II** **QËLLIMI**

Realizimi i veprimtarisë së përbashkët dhe të koordinuar për respektimin, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut; procesit të menaxhimit të të kthyerve në vendin tonë, angazhimin institucional të të gjithë aktorëve shtetërorë të përfshirë në këtë operacion, si dhe sfidat e hasura në këtë drejtim; rritja e bashkëpunimit në drejtim të forcimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi, të transparencës dhe të llogaridhënies; si dhe ndërhyrjen pozitive të institucioneve shtetërore sa herë që është e nevojshme.

### **Neni III** **FUSHA E ZBATIMIT**

Marrëveshja do të zbatohet midis Palëve të lartëpërmendura në fushën e caktuar për të përmbushur qëllimin e saj.

Kjo Marrëveshje do të konsistojë në:

- 3.1 Të bashkëpunojnë në fushën e medias mbi ndërgjegjësimin e gazetarëve për mënyrën e raportimit në kronika televizive, radiofonike dhe media sociale.
- 3.2 Të marrë pjesë në aktivitete që rrisin ndërgjegjësimin e gazetarëve apo të publikut në tërësi, mbi çështje me interes të përbashkët.

- 3.2 Të përfshihen nëpërmjet angazhimit institucional të përbashkët për ndryshime ligjore që lidhen me fushat me interes të përbashkët.
- 3.3 Të njoftojnë njëri-tjetrin mbi raste konkrete që kërkojnë trajtim institucional;
- 3.4 Koordinimi i organizimit të aktiviteteve të përbashkëta, apo të ftojnë njëri-tjetrin për pjesëmarrje në konferenca me interes të përbashkët.
- 3.5 Të bashkëpunojnë duke u përfshirë në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e edukimit, në nivel para universitar dhe universitar.

#### **Neni IV** **KOMUNIKIMI NDËRMJET PALËVE**

- 4.1. Palët angazhohen të mblidhen në mënyrë periodike, sa herë të gjykohet e nevojshme, por jo më rrallë se një (1) herë në vit.
- 4.2. Palët do të caktojnë një person kontakti, që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret edhe në rrugë operationale të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, si dhe për shkëmbimin e informacionit lidhur me të.
- 4.3. Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore. Për rastet kur palët kërkojnë një informacion të rëndësishëm dhe urgjent për t'u përcjellë, komunikimi mund të bëhet dhe në mënyrë elektronike dhe verbale, por në çdo rast përmes personave të kontaktit.

#### **NENI V** **PERSONAT E KONTAKTIT**

Secila nga palët përcakton nga një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura. Në rast të zëvendësimit të personit të kontaktit palët njoftojnë me shkrim njëra-tjetrën duke përcjellë informacionin përkatës.

#### **NENI VI** **KOHËZGJATJA**

- 5.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë kohore 4 vjeçare.
- 5.2 Ndryshimet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
- 5.3 Përveç parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht 60 ditë para me shkrim palën tjetër.
- 5.4 Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, nënshkruhet dhe protokollohet nga çdo palë dhe secila palë mban një kopje origjinale.

5.5 Kjo Marrëveshje është hapur dhe mund t'i bashkohet çdo organizatë jofitimprurëse, objekti i veprimtarisë të së cilës përputhet me këtë Marrëveshje dhe bie dakord me këto parime.

## **NENI VII** **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJES**

Kjo Marrëveshje nuk mund të jetë pjesë e ndonjë konflikti gjyqësor. Çdo keqkuptim që mund të lindë nga interpretimi i tij, do të zgjidhet me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet Palëve.

## **NENI VIII** **DISPOZITAT E FUNDIT**

Palët në marrëveshje obligohen të mos çënojnë veprimtarinë e njëra-tjetrës dhe të mos ndërmarrin veprime me të cilat dëmtojnë reputacionin e tyre.

Palët lidhin këtë Marrëveshje me qëllim respektimin e të gjitha dispozitave bazuar në parime të integritetit, pavarësisë dhe lirisë nga kritika e njëanshme për bashkëpunimin e Palëve dhe ruajtjes së reputacionit të Republikës së Shqipërisë

PËR SA MË SIPËR, Palët e nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi më 11.01.2022 (data, muaji, viti).

Komisioneri për Mbrojtjen  
nga Diskriminimi

Qendra e Koordinimit kundër  
Ekstremizmit të Dhunshëm

**Z.ROBERT GAJDA**

**Znj.LEJDI DERVISHI**

**DREJTOR**

**DREJTOR**

